

VENDIM
Nr. 347, datë 5.6.2024

**PËR DISA SHITESA NË VENDIMIN NR. 503, DATË 27.7.2022, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, "PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR
FINANCIMIN E RINDËRTIMIT TË BANESAVE INDIVIDUALE NË BASHKITË
DURRËS, VORË DHE SHIJAK", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve 13, shkronja "b", nënndarja "i", 25 e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr. 97/2019; të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 97/2023, "Për buxhetin e vitit 2024", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 3, të vendimit nr. 503, datë 27.7.2022, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohen pikat 3/1 dhe 3/2, me këtë përmbajtje:

"3/1 Përdorimin e fondit të rindërtimit, për vitin 2024, nga Bashkia Durrës, në masën 72 409 932 (shtatëdhjetë e dy milionë e katërqind e nëntë mijë e nëntëqind e tridhjetë e dy) lekë pa TVSH, për financimin e rindërtimit të banesave individuale për ata individë, të cilët përfitojnë nga grantet e rindërtimit, banesat e të cilëve janë klasifikuar si objekte që duhen rindërtuar nga e para, sipas aktekspertizave të thelluara, i cili përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2024, dhe i transferohet Bashkisë Durrës në formën e transfertës së pakushtëzuar.

3/2 Efekti financiar, për vitin 2024, përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2024, dhe i transferohet Bashkisë Durrës në formën e transfertës së pakushtëzuar."

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Bashkia Durrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku